



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
10-10-2019
Prishtinë / Pristina
Nr./Br. 1445-2019



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 54 dhe 64 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paragrafit 3.3 të Rregullës Zgjedhore nr. 06/2013 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, të Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, dhe me qëllim të ngritjes së transparencës gjatë aktiviteteve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me date 09. 10.2019, merr këtë:

VENDIM

për rritje të kufizimit të numrit të vëzhguesve nga Subjektet Politike që mund të vëzhgojnë punën e Qendrës për Numërim dhe Rezultate - QNR

- I. Miratohet propozimi për dyfishim të numrit të vëzhguesve nga i njëjta subjekt politik të akredituar mund të jete të pranishëm njëkohësisht për të vëzhguar punën në Qendrën për Numërim dhe Rezultate – QNR, nga 4 në 8 vëzhgues të akredituar për një subjekt politik.
- II. Miratohet propozimi për rritje të numrit të vëzhguesve nga i njëjta subjekt politik i akredituar që mund të jete të pranishëm njëkohësisht për të vëzhguar punën në QNR gjatë procesit të numërimit dhe rinumërimit të jetë i barabartë me numrin e njësive që zbatojnë numërimin dhe rinumërimin.
- III. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar t'i njoftojë subjektet politike që kanë akredituar vëzhgues për këtë vendim.
- IV. Qendra për Numërim dhe Rezultate është e obliguar t'i njoftojë subjektet politike që kanë akredituar vëzhgues për pikën II të këtij vendimi 16 orë para fillimit të aktiviteteve të numërimit dhe rinumërimit në QNR.
- V. Qendra për Numërim dhe Rezultate do t'u lejoj qasje vëzhguesve të përzgjedhur nga subjektet politike dhe që janë të pajisur me distinktiv të vëzhguesit nga KQZ-ja për vëzhgim të plotë të aktiviteteve të QNR-se.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Valdete Daka, Kryetare